

**DEKRET**  
**Nr. 112, datë 9.4.2025**

**PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Zoti Besart Kadia, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Azerbajxhanit, rezident, emërohet edhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Gjeorgji, jo rezident.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**